# Programe edukimi për Disporën - Sezoni Veror për Diasporën

| Institucioni | Programi | Kohëzgjatja | Mosha | Përshkrimi i punës | Aplikimi | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Muzeu Kombëtar i Fotografisë "MARUBI"** | "Summer at Marubi" | 1 Korrik<br>/<br>31 Gusht.<br>2 – 5 javë | 18 – 26 | • Asistencë ndaj vizitorëve,<br>• Pritje në recepsion<br>• Shoqërimin e grupeve<br>• Ndihmesa për ndërtimin e një databaze të bibliotekës së vogël që ofron hapësira e muzeut | Të interesuarit mund të dërgojnë një CV dhe një letër motivimi në adresën info@marubi.gov.al<br>Kandidaturat do të shqyrtohen nga stafi i muzeut dhe të përzgjedhurit do të kontaktohen në adresën e tyre email. | Kjo iniciativë synon të përfshijë të rinjtë shqiptarë që jetojnë jashtë vendit në punën e muzeut gjatë pushimeve verore.<br>Grupi i të rinjve do të trajnohet nga stafi i muzeut, i cili do t'i udhëheqë gjatë gjithë periudhës së tyre të internshipit |
| **Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit** | Summer at AQSHF | Gusht<br>/<br>Shtator<br>2- 4 javë | | Studentët do të praktikohen me:<br>• procesin e hedhjes së të dhënave,<br>• përshkrimin e imazheve,<br>• përpunimin e fjalëve kyçe,<br>• inventarizime dhe<br>• përpilime të listave të koleksioneve;<br>Një proces që do t'u vlejë për t'u njohur nga afër me fondet artistike që ruhen në AQSHF | AQSHF do të shpallë në faqen zyrtare **Thirrjen për Praktika** pranë AQSHF-së, e cila do të paraqesë mënyrën e aplikimit të rinjve të interesuar dhe subjektin e çdo praktike. Aplikimet do të pranohen me email dhe do të shqyrtohen nga grupi i ngritur për këtë arsye në AQSHF. Periudha mars – prill 2019 do të jetë koha e nevojshme që aplikantët të paraqesin letrën e motivimit, dhe CV-në, përpara se studentët e përzgjedhur të kontaktohen për intervistë me skype. | Ky projekt synon:<br>• Hulumtim në fondin filmik dhe në fondet e tjera artistike që disponon AQSHF dhe shkrimi i artikujve studimorë mbi kinematografinë shqiptare që u nevojiten studentëve edhe në detyrat universitare, por që do të përfshihen në një botim studimor që do të publikojë AQSHF mbi kinematografinë shqiptare.<br>• Praktika në AQSHF për digjitalizimin e Fototekës, skedimin e fotove dhe futjen e rekordeve të reja në databazën e koleksioneve së disponon AQSHF. |
| **Teatri Kombëtar** | "Një stinë pranë Arkivit të Teatrit Kombëtar". | Qershor<br>/<br>31 Gusht<br>1-3 muaj | | • Të realizohet digjitalizimi i Arkivit së Teatrit Kombëtar (me përparësi dokumentacioni dhe fotot më të vjetra, vitet '40-'50).<br>• Të bëjnë punë kërkimore dhe shkencore për tezat dhe artikujt e tyre shkencorë. | Të interesuarit ftohen të aplikojnë duke nisur një email me CV-në dhe letrën e tyre të motivimit në adresën elektronike të Teatrit Kombëtar info@teatrikombetar.gov.al<br>Afati i fundit i aplikimit: dt. 31 Maj 2019.<br>Personat e përzgjedhur do të bashkëpunojnë ngushtë me përgjegjësin e stazhit, i cili do të jetë një punonjës i Teatrit Kombëtar. | Me synim që brezi i ri i shqiptarëve të diasporës të njihet me trashëgiminë kulturore të vendit dhe nga ana tjetër të japë kontributin e tij, në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës, Teatri Kombëtar planifikon të ftojë gjatë stinës së verës studentë dhe studiues nga diaspora për punë vullnetare (internship) pranë TK |
| **Qendra Kombëtare Kulturore e Fëmijëve/ Teatri i Kukullave** | "Teatri Veror" | 1 Qershor<br>/<br>31 Gusht | | Pjesëmarrësit, në mënyrë vullnetare, do të përfshihen në aktivitetin e përditshëm të Teatrit të Kukullave gjatë sezonit veror duke dhënë kontributin e tyre si<br>• regjisor, skenograf, kompozitor, piktor dhe aktor në dublimin e shfaqjeve të repertorit,<br>• specialistë marketingu duke promovuar institucionin ndaj publikut artdashës,<br>• ndihmesa për ndërtimin e një baze të dhënash për Institucionin apo hapësirën e teatrit. | Të interesuarit mund të dërgojnë një CV dhe një letër motivimi në adresën qkkf.tirane@yahoo.com brenda datës *(për tu caktuar)*. Kandidaturat do të shqyrtohen nga stafi i institucionit dhe të përzgjedhurit do të kontaktohen në adresën e tyre email. | Gjithashtu gjatë turneut veror që do të organizohet në qytete të ndryshme të vendit, këto vullnetarë mund të jenë pjesë e stafit për realizimin e reportazheve të ndryshme në lidhje me aktivitetet.<br><br>Në momentin që ata vijnë në Shqipëri, grupi do të pritet nga stafi përkatës i cili do t'i udhëheqë gjatë gjithë periudhës së tyre të praktikës *(termi mbetet për tu diskutuar pas dakordësisë me MPJ)*. |
| **Teatri Kombëtar Eksperimental 'Kujtim Spahivogli'** | Teatri me të rinjtë e diasporës | Qershor<br>/<br>Gusht | | • Aktivizim i aktorëve shqiptare të diasporës në projektet teatrore të TKEKS gjatë vitit 2019 e në vazhdim.<br>• Përkthim të veprave të parashikuara në kolanën e të mësuarit. Botim i Institutit të TKEKS.<br>• Përfshirja e artistëve të diasporës më qëllim bashkëpunimin e TKEKS me teatro dhe regjisorë të vendeve të ndryshme. | TKEKS është i interesuar për të rinj të disiplinave aktrim, regji, përkthim dhe shkenca komunikimi për të aplikuar në programet e tyre.<br>Të interesuarit ftohen të aplikojnë duke nisur një email me CV-në dhe letrën e tyre të motivimit në adresën elektronike info@tkeks.gov.al gjatë periudhës 1 Mars – 30 Maj 2019.<br>Për aktorët dhe regjisorë është në varësi të kohështrirjes së projektit ku do të angazhohen. | TKEKS shikon bashkëpunimin më diasporën si një nga pikat mjaft të rëndësishme të aktivitetit të tyre. |
| **MUZEU KOMBËTAR I PËRGJIMEVE "SHTËPIA ME GJETHE"** | "Një ditë në komunizëm"<br><br>"Praktikë muzeologji" | Qershor<br>/<br>Gusht<br>2 javë | mbi 14<br><br>18 - 26 | Hap dyert për të gjithë të rinjtë të cilët dëshirojnë të kryejnë praktikën apo të ushtrojnë profesionin e ciceronit, muzeologut, konservuesit, arkivuesit, hulumtuesit shkencor, kuratori, specialistit të edukimit, etj. | • Aplikantët duhet të dërgojnë CV-në e shkurtër në shqip ose anglisht në adresën info@muzeugjethi.gov.al deri më datë 31 mars.<br>• Të gjithë pjesëmarrësit në këtë program do të pajisen me certifikatë për orët e punës që do të zhvillojnë në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve: "Shtëpia me Gjethe". | "Një ditë në komunizëm" ka si qëllim njohjen e të rinjve me përditshmërinë e shqiptarëve gjatë periudhës së komunizmit, duke trajtuar disa nga aspektet e tij në formën e një punëtorie.<br><br>Programi do të zhvillohet në dhomën edukative të muzeut dhe në ambjente si : dhoma tipike e ndenjes, dhoma e përgjimit, vendstrehimi (do të improvizohet një gjendje alarmi duke shfrytëzuar sistemin e alarmit anti-zjarr), instalacionet në oborr etj. |